



Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, nxjerr:

VENDIM SHPJEGUES PUBLIK NR. 4/2014
PËR
VLERËSIMET dhe RIVLERËSIMET DOGANORE

QËLLIMI

Qëllimi i këtij Vendimi Shpjegues Publik është të sqaroj detyrimet tatimore, mënyrën e deklarimit dhe pagesës së Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, Tatimit në të Ardhurat Personale dhe Tatimit në të Ardhurat e Korporatave, për tatimpaguesit, veprimtaria e të cilëve është e lidhur me importin e mallrave / pajisjeve, në rastet kur këto importe iu nënshtrohen Vlerësimeve apo Rivlerësimeve Doganore.

PËRKUFIZIM

Për qëllimin e këtij Vendimi Shpjegues Publik, përkufizimi në vazhdim ka këtë kuptim:

Dokument Unik Doganor - dokumenti që ka formën e përcaktuar me Legjislacion Doganor, i cili shfrytëzohet brenda strukturës së tregtisë së mallrave me shtetet e treta duke përfshirë Procedurat e Doganës të lidhura me këtë tregti.

BAZA LIGJORE

Neni 13, paragrafi 3 dhe 5 i Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, përcaktojnë krijimin dhe mbajtjen e regjistrave, citojmë:

“Librat dhe regjistrimet për bizneset me qarkullim vjetor mbi pesëdhjetëmijë (50.000) euro duhet të mbahen në përputhje me parimet e përgjithshme të pranueshme të kontabilitetit të Kosovës që janë plotësuar me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.”

“Mallrat që posedon tatimpaguesi duhet të dokumentohen me dokumente mbi origjinën.”

Neni 17, paragrafi 4 i Udhëzimit Administrativ nr. 15/2010 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, përcakton kërkesat për libra dhe regjistrime, citojmë:

“Shoqëritë me qarkullim vjetor bruto më shumë se 50,000 € dhe ato të cilat zgjedhin të përcaktojnë detyrimet e tyre tatimore, bazuar në mbajtjen e librave dhe regjistrimeve e duhura, duhet të mbajnë libra dhe regjistrime në përputhje me kërkesat e standardeve të kontabilitetit në Kosovë. Librat dhe regjistrimet e mbajtura, duhet të jenë mjaftueshëm të sakta, për të mundësuar kontabilitet të plotë dhe saktë të të gjitha pikave të të ardhurave dhe shpenzimeve të aplikueshme në një periudhë tatimore”.

Neni 19, paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2010 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, përcakton origjinën e mallit, citojmë:

*“... Paragrafi 5 i Nenit 13 të Ligjit, parashikon që mallrat në zotërim të një tatimpaguesi të jenë të dokumentuara mbi origjinën. Kjo nënkupton se një tatimpagues duhet të jetë në gjendje të ofrojë dokumentacionin mbështetës, i cili arsyeton prejardhjen e mallit si në vendndodhjen, apo vendndodhjet e tatimpaguesit, ashtu edhe për mallrat në qarkullim (jashtë vendndodhjes/eve) së tatimpaguesit). Tatimpaguesit, duhet të jenë në gjendje të dokumentojë të gjitha mallrat nga koha e pranimit (qoftë përmes importimit, blerjes, apo shkëmbimit apo mënyrave tjera) deri sa ato të jenë shitur apo ndryshe të jenë sistemuar, përfshirë dokumentacionin e shitjes apo sistemim tjetër. Në dokumentacionin e mundshëm që duhet të mbahet janë të përfshira:
... Dokument kyç për qëllime të ATK, është DUD, i cili është evidencë e pranueshme se mallrat kanë kaluar përmes kufirit dhe i kanë kaluar procedurat e doganave”.*

Neni 25, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 03/L-146 për TVSh, përcakton shumën e tatueshme lidhur me importimin e mallrave, citojmë:

“....., në lidhje me importimin e mallrave, shumën e tatueshme duhet të jetë vlera për qëllime doganore, e përcaktuar në pajtueshmëri me legjislacionin doganor të Kosovës në fuqi”.

Neni 36, paragrafi 2 i Ligjit Nr. 03/L-146 për TVSh, përcakton të drejtën për të zbritur TVSh-në, citojmë:

“Përveç nëse është përcaktuar ndryshe me këtë Ligj, personi i tatueshëm mundë të zbres nga obligimet e tij të TVSH-së, obligimin e TVSH-së apo TVSH-në e paguar në lidhje me blerjet e mallrave dhe shërbimeve këtu e tutje: TVSH e zbritshme, me kusht që ai të ketë shfrytëzuar apo do të shfrytëzojë ato mallra ose shërbime për qëllime të transaksioneve të tij të tatueshme”.

Neni 53, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 03/L-146 për TVSh, përcakton periudhën tatimore për TVSh, citojmë:

“Periudha tatimore e të gjithë personave të tatueshëm duhet të jetë çdo muaj kalendarik”.

Neni 15, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 03/L-161 për Tatim në të Ardhura Personale, përcakton dispozitat e përgjithshme të shpenzimeve, citojmë:

“Në varësi të dispozitave të këtij neni, lejohen si zbritje nga të ardhurat e përgjithshme të krijuara nga pasuria e paprekshme, qiratë apo aktivitetet afariste shpenzimet e paguara ose të shkaktuara gjatë periudhës tatimore që janë tërësisht, vetëm dhe drejtpërdrejt të lidhura me aktivitetet e tilla që gjenerojnë të ardhura, përfshirë primet për sigurim shëndetësor, të paguara në interes të punëtorit dhe ato të varura që duhet të përfshihen në polisën e të punësuarit”.

Neni 9, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 03/L-162 për Tatim në të Ardhura të Korporatave, përcakton shpenzimet e lejueshme, citojmë:

“Në varësi të kufizimeve të këtij Ligji, në përcaktimin e të ardhurave të tatueshme, tatimpaguesit i lejohej zbritje nga të ardhurat bruto të paguara ose të bëra vetëm gjatë periudhës tatimore në tërësi dhe ekskluzivisht përkitazi me veprimtarinë e tij ekonomike, përfshirë primet për sigurim shëndetësor, të paguara në interes të punëtorit dhe ato të varura që duhet të përfshihen në polisën e të punësuarit”.

VLERËSIMI / RIVLERËSIMI DOGANOR

Vlerësimi doganor bëhet me rastin e importimit të mallrave, ndërsa rivlerësimi doganor bëhet pasi të ketë ndodhur zhdoganimi i mallrave.

Për qëllime të TVSh-së, **Dokumenti Unik Doganor - DUD është bazë për llogaritjen e TVSh-së së zbritshme** (TVSh e cila paguhet me rastin e importit të mallit).

Për të gjitha rastet për të cilat Dogana ndërmerr veprimet e vlerësimit / rivlerësimit të **mallrave apo pajisjeve**, duke ndryshuar bazën doganore, tatimpaguesi duhet të bëjë rregullimet e nevojshme për qëllime tatimore.

Efektet e vlerësimeve / rivlerësimeve doganore, si dhe vendimet nga Organet kompetente për shqyrtim të ankesave (Dogana e Kosovës, Bordi i Pavarur për Rishqyrtime apo Gjykata), janë pasqyruar përmes shembujve në vijim:

Shembulli nr. 1:

Tatimpaguesi "X", më 12 Prill 2013 bën importin e **mallrave** në vlerë prej 3,000€. Me rastin e zhdoganimit të mallrave, Dogana bën vlerësimin doganor duke rritur bazën doganore për 1,500€. Pra vlerësimi i tërësishëm nga dogana bëhet, si në vijim:

Fatura	3,000.00€
Rritja e bazës doganore	1,500.00€
Baza Doganore	4,500.00€
Taksa Doganore 10%	450.00€
Shuma e tatueshme	4,950.00€
Obligimi për TVSh (16%)	792.00€
Gjithsejtë obligimi	1,242.00€

Regjistrimi për TVSh

Për aspekte të TVSh-së, paraqitja në formularin e deklarimit të TVSh-së për muajin Prill / 2013 duhet të bëhet në rubrikat, si në vijim:

[27] Importet e tatueshme	4,950.00€	[28]	792.00€
---------------------------	-----------	------	---------

Vlerësimi doganor është apeluar dhe vendimi rezulton pozitiv për tatimpaguesin. Vendimi nga Organi kompetent është nxjerrë më 27 Maj 2014, i cili rezulton si në vijim:

Taksa Doganore 10%	150.00€
TVSh 16%	264.00€
Gjithsejtë	414.00€

Pas marrjes së Vendimit nga Organi kompetent, për qëllime tatimore duhet të bëhen rregullimet në formularin e deklarimit të TVSh-së për periudhën Maj / 2014, si në vijim:

[18] Rregullimet për të rritur TVSh-në për pagesë	1,650.00€	[19]	264.00€
---	-----------	------	---------

Regjistrimi për TAP / TAK

Vlerësimi doganor në vlerë prej 1,650€ (1,500€ + 150€), i bërë me rastin e zhdoganimit të mallrave, kompania e cila e ka njohur si Kosto, duhet të bëjë korrigjimin e nevojshëm dhe të njëjtën shumë ta trajtoj si të hyrë në periudhën e vendimit nga Dogana.

Shembulli nr. 2:

Tatimpaguesi "X", më 08 Mars 2013 bën importin e **mallrave** në vlerë prej 5,000€. Me rastin e zhdoganimit të mallrave, Dogana bën vlerësimin doganor i cili është i njëjtë me faturën komerciale 5,000€. Pra vlerësimi nga Dogana bëhet, si në vijim:

Fatura	5,000.00€
Rritja e bazës doganore	0.00€
Baza Doganore	5,000.00€
Taksa Doganore 10%	500.00€
Shuma e tatueshme	5,500.00€
Obligimi për TVSh (16%)	880.00€
Gjithsejtë obligimi	1,380.00€

Regjistrimi për TVSh

Për aspekte të TVSh-së, paraqitja në formularin e deklarimit të TVSh-së për muajin Mars / 2013 duhet të bëhet në rubrikat, si në vijim:

[27] Importet e tatueshme	5,500.00€	[28]	880.00€
---------------------------	-----------	------	---------

Dogana e Kosovës – Sektori i Kontrollit Pas-importues, me datën 28 Shkurt 2014 bën rivlerësim doganor për importin sipas shembullit nr. 2 duke rritur bazën doganore për 3,000€ dhe për tatimpaguesin nxjerrë këtë vendim:

Rivlerësimi Doganor	3,000.00€
Taksa Doganore 10%	300.00€
Baza për TVSh	3,300.00€
TVSh 16%	528.00€
Gjithsejtë	828.00€

Pas marrjes së Rivlerësimit nga Dogana e Kosovës, për qëllime tatimore duhet të bëhen rregullimet në formularin e deklarimit të TVSh-së për periudhën Shkurt / 2014, si në vijim:

[39] Rregullimet për të ulur TVSh-në për pagesë	3,300.00€	[40]	528.00€
---	-----------	------	---------

Regjistrimi për TAP / TAK

Rivlerësimin doganor në vlerë prej 3,300€ (3,000€ + 300€), të bërë nga Sektori i Kontrollit Pas-importues, tatimpaguesi ka të drejtë të njoh si Kosto në periudhën e Rivlerësuar nga Dogana e Kosovës.

Shembulli nr. 3:

Tatimpaguesi "X", më 09 Janar 2012 bën importin e **pajisjeve** (Kategoria e II-të) në vlerë prej 10,000€. Me rastin e zhdoganimit të mallrave, Dogana bën vlerësimin doganor duke rritur bazën doganore për 2,000€. Pra vlerësimi i tërësishëm nga dogana bëhet, si në vijim:

Fatura	10,000.00€
Rritja e bazës doganore	2,000.00€
Baza Doganore	12,000.00€
Taksa Doganore 10%	1,200.00€
Shuma e tatueshme	13,200.00€
Obligimi për TVSh (16%)	2,112.00€
Gjithsejtë obligimi	3,312.00€

Regjistrimi për TVSh

Për aspekte të TVSh-së, paraqitja në formularin e deklarimit të TVSh-së për muajin Janar / 2013 duhet të bëhet në rubrikat, si në vijim:

[29] Importe investive të tatueshme	13,200.00€	[30] 2,112.00€
-------------------------------------	------------	----------------

Vlerësimi doganor është apeluar dhe vendimi rezulton pozitiv për tatimpaguesin. Vendimi nga Organi kompetent është nxjerrë më 25.03.2014, i cili rezulton si në vijim:

Taksa Doganore 10%	200.00€
TVSh 16%	352.00€
Gjithsejtë	552.00€

Pas marrjes së Vendimit nga Organi kompetent, për qëllime tatimore duhet të bëhen rregullimet në formularin e deklarimit të TVSh-së për periudhën Mars/2014, si në vijim:

[18] Rregullimet për të rritur TVSh-në për pagesë	2,200.00€	[19] 352.00€
---	-----------	--------------

Regjistrimi për TAP / TAK

Nëse vlerësimi doganor në vlerë prej 2,200€ (2,000€ + 200€), i bërë me rastin e zhdoganimit të mallrave, është njohur nga tatimpaguesi bazë për zhvlerësim të pajisjes (gjatë periudhës tatimore 2012), atëherë bazuar në vendimin e lartpërmendur, tatimpaguesi obligohet që në vitin 2014 të bëjë rregullimet e nevojshme:

Aseti i vlerësuar nga Dogana $12,000€ + 1,200€ = 13,200€$
Zhvlerësimi i akumuluar gjatë dy viteve: $13,200 / 5 = 2,640 \times 2 = 5,280€$
Vlera e asetit në bazë të vendimit $10,000€ + 1,000€ = 11,000€$
Zhvlerësimi për periudhën $11,000 / 5 = 2,200€ \times 2 = 4,400€$
Rregullimi: $5,280€ - 4,400€ = 880€$. Kjo shumë duhet të njihet si e hyrë e periudhës.
Baza për zhvlerësim të mëtotjeshëm (për tri vitet e ardhshme) do të jetë 11,000€.

Shembulli nr. 4:

Tatimpaguesi "X" më 10 Shkurt 2012 bën importin e **pajisjeve** (Kategoria e II-të) në vlerë prej 8,000€. Me rastin e zhdoganimit të mallrave, Dogana bën vlerësimin doganor i cili është i njëjtë me faturën komerciale 8,000€. Pra vlerësimi nga Dogana bëhet, si në vijim:

Fatura	8,000.00€
Rritja e bazës doganore	0.00€
Baza Doganore	8,000.00€
Taksa Doganore 10%	800.00€
Shuma e tatueshme	8,800.00€
Obligimi për TVSh (16%)	1,408.00€
Gjithsejtë obligimi	2,208.00€

Regjistrimi për TVSh

Për aspekte të TVSh-së, paraqitja në formularin e deklarimit të TVSh-së për muajin Shkurt / 2012 duhet të bëhet në rubrikat, si në vijim:

[29] Importe investive të tatueshme	8,800.00€	[30] 1,408.00€
-------------------------------------	-----------	----------------

Dogana e Kosovës – Sektori i Kontrollit Pas-importues, me datën 05 Qershor 2014 bën rivlerësim doganor për importin sipas shembullit nr. 4 duke rritur bazën doganore për 2,500€ dhe për tatimpaguesin nxjerrë këtë vendim:

Taksa Doganore 10%	250.00€
TVSh 16%	440.00€
Gjithsejtë	690.00€

Pas marrjes së Rivlerësimit nga Dogana e Kosovës, për qëllime tatimore duhet të bëhen rregullimet në formularin e deklarimit të TVSh-së për periudhën Qershor / 2014, si në vijim:

[39] Rregullimet për të ulur TVSh-në për pagesë	2,750.00€	[40] 440.00€
---	-----------	--------------

Regjistrimi për TAP / TAK

Rivlerësimin doganor në vlerë prej 2,750€ (2,500€ + 250€), të bërë nga Sektori i Kontrollit Pas-importues, tatimpaguesi duhet të bëjë korrigjimet e nevojshme për çështje të bazës për zhvlerësim. Korrigjimi duhet të bëhet në vlerën prej 2,750€ (2,500€+250€) në periudhën tatimore në të cilën është bërë rivlerësimi. Baza e re do të zhvlerësohet gjatë tri viteve të ardhshme.

Aseti i vlerësuar nga Dogana $8,000€ + 800€ = 8,800€$

Zhvlerësimi i akumuluar gjatë dy viteve: $8,800/5 = 1,760 \times 2 = 3,520€$

Vlera e mbetur e asetit pas vitit të dytë = $8,800 - 3,520 = 5,280€$

Vlera e asetit në bazë të rivlerësimit doganor është rritur për 2,750€

Rregullimi pas rivlerësimit:

Vlera fillestare = 8,880€

Rivlerësimi doganor = 2,750€

Baza e re për zhvlerësim = 11,550€

Zhvlerësimi për periudhën = 11,550€ / 5 = 2,310€

Rregullimi: 3,520€ - 4,620€ = -1,100€. Kjo shumë duhet të njihet shpenzim i periudhës.
Baza për zhvlerësim të mëtuajtshëm (për tri vitet e ardhshme) do të jetë 11,550€.

RREGULLIMET

Në të gjitha rastet kur vendimet e Doganës janë apeluar dhe kanë pësuar ndryshime, tatimpaguesi duhet t'i bëjë rregullimet e nevojshme, në pajtim me vendimet gjegjëse.

Rregullimet për qëllime tatimore duhet të bëhen në periudhën e Vendimit duke inkorporuar efektet.

Të gjitha rregullimet duhet të bazohen në kalkulimet e bëra në mënyrë specifike, duke pasqyruar kronologjinë e ngjarjeve.


PËRFUNDIM

Kostot e Mallrave dhe Aseteve të importuara, do të trajtohen në bazë të Dokumentit Unik Doganor - DUD.

HYRJA NË FUQI

Ky Vendim Shpjegues Publik hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së.

Data: 25 / 11 / 2014

Drejtori i Përgjithshëm ATK

(Behxhet Haliti)

